



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:234123

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05861155

PAKR.nr.747/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Skënder Çoçaj, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: J.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK dhe V.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të mbrojtësve së të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, të ushtruara kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.33/2023, të dt.27.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.25.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e mbrojtësve së të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.33/2023, të dt.27.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.33/2023, të dt.27.10.2023, janë shpallur fajtor të akuzuarit, J.K., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, dhe V.K., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPK, dhe u janë shqiptuar dënimet,

-të akuzuarit J.K., dënimi me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) Euro, si dhe me dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, ashtu që në dënimin me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim, nga data 08.11.2022, gjerë me dt. 06.12.2022, 29 ditë.

Është obliguar i akuzuari J.K. që dënimin me gjobë ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK, nëse i njëjti nuk dëshiron, ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë, në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg, nga 20 Euro.

-të akuzuarit V.K., dënimi me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, si dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, në të cilin dënim me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 08.11.2022, gjerë me dt.06.12.2022.

Është obliguar i akuzuari, që dënimin me gjobë ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK, nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë, në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Në kuptim të nenit 269 të KPPK, në lidhje me nenin 267 par.5 të KPK, nga i akuzuari J.K., janë konfiskuar: një qese najloni brenda së cilës ishin 10 qese të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 11.15 gram; substancë narkotike e llojit marihuanë, me peshë prej 1.78 gram; një qese plastike me ngjyrë të kaltër e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 125.29 gram; një sasi e vogël e lëndës narkotike të llojit marihuan e fshehur në pako të cigareve, me peshë prej 0.58 gram; një peshore elektrike ngjyrë hiri, një qese e vogël e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 2.25 gram; një qese plastike e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 28.68 gram; dy qese najloni brenda një çante në të cilat qese ishin 16 paketime plastike me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 941.26 gram, një qese plastike e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 6.13 gram; një qese plastike brenda së cilës ishin shumë qese plastike të vogla, pesë qese plastike brenda së cilave kishte shumë qese plastike, një qese plastike brenda së cilës kishte disa qese plastike të vogla, e që pas ekzaminimit, konstatohet se kemi të bëjmë me substancën narkotike të llojit kanabis (marihuan) që përmban tetrahidrokanabinal në peshë neto të përgjithshme prej 896.19 gram, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Nga i akuzuari V.K., në kuptim të nenit 269 të KPPK, në lidhje me nenin 269 par.3 të KPK, është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuan në sasi prej 0.58 gram, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarit J.K., i kthehet një telefon mobil “IPHON X” ngjyrë e zezë mbrapa i thyer, ndërsa të akuzuarit V.K., i kthehet një telefon mobil “IPHON X” ngjyrë e bardhë.

Janë obliguar të akuzuarit, që secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 150 Euro si dhe shumën prej nga 50 Euro, në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit J.K., av.Hasan Biraj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarit J.K., ti shqiptoj dënim në kuptim të nenit 72 pika 1.4 të KPK, ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit V.K., av.Muhamet Shalaj, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.33/2023, të dt.27.10.2023, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.2/2024, të datës 05.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, ka propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.33/2023, të dt.27.10.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit me dt.25.06.2024, pasi që i ka njoftuar në mënyrë të rregull të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, mbrojtësit e të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, si dhe i akuzuari V.K., kurse nuk ka prezantuar i akuzuari J.K. dhe Prokurori i Apelit, përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.K., av.Hasan Biraj, ka deklaruar se ngel pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet të cilat janë potencuar në ankesën e ushtruar, propozon që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, ose që çështja penale të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.K., av.Muhamet Shalaj, ka deklaruar se ngel pranë ankesës së ushtruar dhe kërkon që të mbrojturit të tij, ti shqiptohet dënim më i butë.

I akuzuari V.K., ka deklaruar se pajtohet me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e mbrojtësve së të akuzuarve, J.K., av.Hasan Biraj, dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, nuk janë të bazuara.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit J.K., av.Hasan Biraj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pretenduar se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i pa kuptimtë është në kundërshtim me vetveten si dhe pjesë të tjera të aktgjykimit. në këtë çështje penale përkundër asaj që me dt.17.01.2023, kemi ushtruar kërkesë për hyrje në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, sikurse është paraparë në dispozitat përkatëse ligjore, e njëjta nuk është arritur pasi që prokuroria nuk e ka dhënë pëlqimin, andaj nga kjo rezulton se edhe pse kemi kërkuar që të veçohet procedura në drejtim në këtu të akuzuarin, edhe ky veprim procedural nuk është kryer.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit J.K., av.Hasan Biraj, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara, nga neni 384 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, nga neni 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm, në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizonin veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, është përkujdesur në mënyrë të qartë që të vërtetoj elementet inkriminuese të kësaj vepre, për të cilën i akuzuari është akuzuar. Po ashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsyet të mjaftueshme që në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara më lartë, e cila rezulton nga të gjitha shkresat e lëndës, sikurse janë provat personale, po ashtu edhe ato materiale. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha veprimet gjatë të gjitha fazave të procedurës, dhe ka ardhur në përfundim që të njëjtat janë ndërmarrë në përputhshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, ashtu që pretendimet e mbrojtësit së të akuzuarit nuk kanë bazë juridike, pasi që gjatë punës janë vlerësuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, e po ashtu janë zbatuar dispozitat ligjore të KPPK. Në këtë çështje penale, përkundër asaj që i akuzuari J.K., që të hyjë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, prokuroria sipas dispozitave përkatëse ligjore është e obliguar që të bëjë vlerësimin e secilës shkresë të marrur nga ana e palëve në procedurë, dhe të sqaroj pranimin apo mos pranimin e ndonjë propozimi, që në rastin konkret ka refuzuar që ta bëjë pranimin e së njëjtës, sepse nuk kanë lejuar veprimet

inkriminuese të akuzuarit, për këtë lloj të veprës penale, ngase ka qenë pretendimi i mbrojtjes që nga ana e të akuzuarit është kryer vepra penale më e lehtë.

Pasi që ka vlerësuar prokuroria që nuk ka kushte ligjore për pranimin e fajësisë, dhe veçimin e procedurës penale, ka proceduar me të gjitha provat nga shkresat e lëndës, sikurse janë provat personale, duke dëgjuar në këtë çështje penale të akuzuarit J. dhe V.K., duke vlerësuar edhe provat materiale nga shkresat e lëndës dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Kolegji po ashtu ka vlerësuar se në këtë çështje penale i akuzuari ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, e cila është vërtetuar nga të gjitha provat nga shkresat e lëndës, andaj edhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale pasi që është vërtetuar se i njëjti përkatësisht i akuzuari ka mbajtur pa autorizuar me qëllim të shitjes apo të shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, atëherë ka vendosur në mënyrë të drejtë që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Po ashtu ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, sikurse parashihet dispozita ligjore nga neni 369 par.7 të KPPK, duke u përkujdesur që të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte janë vërtetuar në këtë çështje penale, e po ashtu ka paraqitur në mënyrë të veçantë saktësinë e provave kundërthënëse, si dhe arsyet e mos miratimit të propozimeve të cilat janë ngritur nga ana e palëve në procedurë, të cilat kanë qenë me rëndësi për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Edhe sipas shkeljeve të ligjit penal, mbrojtësi i të akuzuarit, ka ushtruar ankesë, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, e ka shkel ligjin penal në dëm të të akuzuarit, duke pretenduar se në këtë çështje penale për të akuzuarin Amir Bojzhiu dhe Lavdim Morina, të cilët kanë hyrë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe e njëjta marrëveshje është arritur, është vepruar më tutje në procedurë të paraparë ligjore, që rezulton edhe nga procesverbali i dt.03.03.2023, të cilën ditë është kërkuar që të veçohet edhe procedura për të akuzuarin J.K., por e njëjta nuk është pranuar, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, që mund të vihet në përfundim se është shkelur e drejta e këtu të akuzuarit për pranim të fajësisë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me këto shkelje që janë të parapara në nenin 385 të KPPK, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar të gjitha dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi, ka vepruar sipas të njëjtave që në rastin konkret drejt ka vendosur kur nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë, si dhe veçimin e procedurës për të akuzuarin J.K., pasi që ka vlerësuar se në këtë çështje penale për hir të vërtetimit të gjendjes faktike, është dashur që të procedohet me të gjitha provat të cilat kanë qenë të grumbulluara dhe janë vlerësuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji i kësaj gjykate po ashtu ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe se në veprimet

e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, që është e paraparë me ligjin e aplikueshëm, e pasi që nuk ka gjetur që në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuluar elementet qenësore për këtë vepër penale, atëherë edhe nuk ka aplikuar institutin e përjashtimit të akuzuarit nga ndjekja penale si dhe përgjegjësia penale, që nënkupton se i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe se të njëjtit i ka shqiptuar dënim përkatës ligjor, në kuadër të kompetencës ligjore që nënkupton se aktgjykimi nuk përfshihet në shkeljet e ligjit penal nga neni 385 i KPPK.

Nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit J.K., av.Hasan Biraj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese dhe të gjitha faktet që shkojnë në favore të të akuzuarit. Me vlerësimin e rrethanave lehtësuese të cilat janë prezantuar, do të ndikonin që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i favorshëm, përkatësisht më i ulët sesa ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ashtu që gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese vetëm pranimin e fajësisë, por jo edhe benifitet e tjera të parapara nga kjo çështje penale, kurse si rrethanë rënduese ka vlerësuar se i akuzuari është përsëritës i veprave penale, pa marrë ndonjë aktgjykim apo vendim tjetër, për tu thirrur në të njëjtin, andaj në këtë drejtim jemi të bindur se vendimi për dënimin nuk është i drejtë dhe propozojmë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë, në prani të këtyre rrethanave ose që çështja penale të kthehet në rigjykim e vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.K., av.Muhamet Shalaj, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar se një vendim i marrë i tillë është i ashpër, posaçërisht duke pasur parasysh se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar thellësisht për një veprim të tillë, se ka qenë korrekt gjatë të gjitha fazave të procedurës, andaj nuk janë vlerësuar këto rrethana që sipas mendimit tonë jemi të bindur se me këtë lloj dënimi nuk pritët të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, i paraparë me ligj.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesave të ushtruara nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve J.K., av.Hasan Biraj dhe V.K., av.Muhamet Shalaj, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton në bazë të deklaratave të akuzuarve, të cilët kanë pranuar fajësinë secili për verën penale e cila i vihet në barrë, e po ashtu edhe në bazë të vlerësimit të provave materiale, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, ashtu që si rrethanë lehtësuese kundër të akuzuarve J.K. dhe V.K., ka pasur parasysh se i akuzuari J., përkundër asaj që rezulton se i njëjti është recidivist, nuk ka paraqitur ndonjë aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë, që është i plotfuqishëm, me dhënë numrin e saktë të të njëjtëve, se në këtë çështje penale përkitazi me të akuzuarin V.K., gjykata ka pasur parasysh faktin se edhe ky është recidivist, pa paraqitur numrin e ndonjë aktgjykimi të shkallës së parë, mirëpo kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale për secilin të

akuzuar, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, kurse si rrethanë lehtësuese, ka pasur parasysh se të akuzuarit, kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, se janë të moshës relativisht të re, se janë të gjendjes së dobët materiale, andaj në prani të këtyre rrethanave secilit prej tyre i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Ka vlerësuar që të dy ankesat për secilin të akuzuar, nga të cilat nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykate është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit të parë dhe të dytë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.747/2023, të datës 25.06.2024

**Procesmbajtës,
Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi**

Skënder Çoçaj